



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 tetor 2013
Nr. Ref.:RK485/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI91/13

Parashtrues të kërkesës

Shpend Zajmi, Avni Kryeziu dhe 19 të tjerë

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve Nr. 681, të 15 marsit 2012,
përkatësisht Nr. 338, të 1 shkurtit 2013, të Rektoratit të Universitetit të
Prishtinës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Shpend Zajmi, Avni Kryeziu, Irfan Daullxhiu, Badri Mulaj, Suzana Krasniqi, Bahrie Halili, Fitore Komoni, Vesel Skënderi, Arbër Tolaj, Lirie Gashi, Luljeta Luzha, Sadik Rashiti, Burbuqe Skënderi, Sylejman Halili, Florim Shaqiri, Afrim Tahiri, Musa Jashari, Lulzim Sadiku, Shpresa Rexha, Burhan Hadri dhe Islam Krasnqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit), studentë në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë.

Vendimet e kontestuara

2. Vendimet Nr. 681, të 15 marsit 2012, përkatësisht Nr. 338, të 1 shkurtit 2013, të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Kërkesa ka për objekt çështjeje të drejtën e parashtruesve për vazhdimin e afatit për studime postdiplomike. Rektorati i Universitetit të Prishtinës kishte vendosur që parashtruesve t'iu refuzohet kërkesa për vazhdimin e afatit për studime postdiplomike duke pohuar se parashtruesit kanë qenë të njoftuar për afatin kohor për përfundimin e studimeve.

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 qershor 2013, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 korrik 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI91/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI91/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu (anëtarë).
7. Më 15 korrik 2013, parashtruesit u njoftuan për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Rektoratit të Universitetit të Prishtinës.
8. Më 13 shtator 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Në vitin akademik 2002/2003, parashtruesit janë regjistruar për studime postdiplomike në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës.
10. Më 15 mars 2012, Rektorati i Universitetit të Prishtinës njoftoi parashtruesit se Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës kishte marrë vendim i) për lejimin e vijimit të studimeve nga studentët me sistem të vjetër të studimeve themelore dhe të magjistraturës në Fakultetin e Mjekësisë, ii) vijimi i studimeve për këta studentë (duke përfshirë edhe parashtruesit) mundësohet deri më 30 shtator 2012.

11. Më 1 shkurt 2013, Rektorati i Universitetit të Prishtinës njoftoi parashtruesit se Senati i Universitetit të Prishtinës kishte marrë vendim: i) refuzohet kërkesa për kohëzgjatjen e studimeve për studentët (duke përfshirë dhe parashtruesit), të cilët nuk i kanë përfunduar studimet e magjistraturës të regjistruara para hyrjes në fuqi të statutit nr. 318, të 5 korrikut 2004, ii) meqenëse Fakulteti i Mjekësisë nuk organizon studime master për studentët e mjekësisë me program të studimeve 5 dhe 6-vjeçare, studentët e kategorisë si në pikën (i) të këtij vendimi (duke përfshirë edhe parashtruesit) kanë të drejtë që të konkurrojnë direkt për programe të doktoratës pasi që gjatë studimeve themelore kanë grumbulluar 300 apo 360 ECTS.

Pretendimet e parashtruesve

12. Parashtruesit pretendojnë se i kanë kaluar të gjitha provimet e parapara me planprogramin përkatës dhe se i kanë kryer të gjitha obligimet financiare ndaj administratës së Fakultetit të Mjekësisë. Parashtruesit po ashtu pretendojnë se kanë marrë pëlqimin e komisioneve përkatëse të Fakultetit të Mjekësisë përkitazi me temat e magjistraturës, porse kanë ngecur te komisioni i fundit për mbrojtjen e temës së magjistraturës.
13. Parashtruesit pretendojnë se vendimet e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës që përcaktonin afatin për kryerjen e studimeve janë të padrejta dhe se cenojnë të drejtat e tyre kushtetuese të garantuara me nenin 47 [E Drejta për Arsimin] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Parashtruesit pohojnë se vendimet në fjalë nuk u janë komunikuar atyre në formë të shkruar, gojore apo në ndonjë formë tjetër.
14. Përfundimisht, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që: i) ta vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës përkitazi me ndërprerjen e studimeve postdiplomike, ii) të anulojë vendimet në fjalë, dhe iii) t'ua mundësojë atyre vazhdimin e studimeve postdiplomike përkatësisht mbrojtjen e temës së magjistraturës.

Vlerësim i pranueshmërisë

15. Për të qenë në gjendje për ta shqyrtuar kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
16. Përkitazi me kërkesën e parashtruesve, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

17. Gjykata i referohet rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, që përcakton:

(1) “Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar...”

18. Gjykata vlerëson se formulimi i nenit 113.7 të Kushtetutës i obligon individët që realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese ta kërkojnë tek autoritetet publike që nënkupton organet administrative dhe gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës para se ata t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.
19. Arsyeimi mbi rregullin e shterimit është që t'u ofrohet autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih rastin KI41/09, parashtrues i kërkesës AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, shih rastin Selmouni kundër Francës, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Vendim i 28 korrikut 1999).
20. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesit për realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese duhet t'i shterojnë mjetet juridike tek organet kompetente; dhe vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve, gjegjësisht, pas shterjes së mjeteve juridike, ata mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, nëse e gjykojnë të nevojshme, dhe atë brenda afatit katër (4)-mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
21. Përkitazi me afatet ligjore, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.
22. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që përcakton:

(1) “Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
[...]
b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”
23. Nga dokumentet e dorëzuara shihet që vendimi i fundit i Rektoratit të Universitetit të Prishtinës është shpallur më 1 shkurt 2013, kurse parashtruesit kërkesën e tyre e dorëzuan në Gjykatë më 28 qershor 2013, përkatësisht kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit katër (4)-mujor siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
24. Rezulton se kërkesa është e paafatshme.

25. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenet 49 dhe 19.4 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) dhe të Rregullores së punës, më 13 shtator 2013, me shumicë votash:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani